



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA KOORDINIMIT DHE MONITORIMIT TË KONTRATAVE

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 91, Datë 25.09.2024

MONITORIM I KRYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP X • Reklamim nga të tretë
Numri i kontratave	10 (dhjetë)
Konstatimet kryesore	1. Autoriteti kontraktor, në disa raste ka administruar formularët e sigurimit të kontratës me të dhëna që nuk i përkasin AK, por Organit Qendror Blerës, që ka zhvilluar procedurën e prokurimit. 2. Planet e zbatimit të kontratave, të hartuar nga AK, kanë mangësi përse i përket çështjeve organizative e teknike të kontratave, që lidhen me zbatimin e tyre. 3. Njëkohësisht, formularët e raportimit për zbatimin e kontratës duhet të hartohet sipas formatit të miratuar nga APP, si dhe duke u pasqyruar saktë të dhënat që lidhen me ecurinë e zbatimit të kontratave. 4. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me pikën 1, të nenit 124, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe pikës 7, të nenit 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi për kontratat objekt hetimi, nuk ka administruar gjatë zbatimit të kontratës gjithë dokumentacionin e

	nevojshëm, si dhe nuk ka kryer verifikimet përkatëse, për të siguruar që malli i dorëzuar i plotëson kërkesat e cilësisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në kontratë. Gjithashtu, referuar të dhënave të dokumenteve shoqëruese të mallit, rezulton se disa artikuj nuk përmbushin specifikimet teknike të parashikuara në dokumentet e tenderit.
Masat e marra	Në bazë të neneve 23, gërma “e”, dhe 132, pika 1/k, 2 dhe 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, APP vendosi të dënojë me gjobë 8 persona të evidentuar përgjegjës për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në vendim, si dhe të propozojë dhënien e masë disiplinore për 1 person, të evidentuar përgjegjës për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në vendim.